

VENDIM
Nr.84, datë 2.2.2011

**PËR MIRATIMIN E PROTOKOLLIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
REPUBLIKËS SË ÇEKISË, PËR NDRYSHIMET NË MARRËVESHJEN NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË ÇEKISË “PËR NXITJEN DHE
MBROJTJEN E NDËRSJELLË TË INVESTIMEVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e protokollit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Çekisë, për ndryshimet në marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Çekisë “Për nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjellë të investimeve”, nënshkruar më 27 qershor 1994, në Pragë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PROTOKOLL
**NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS ÇEKE MBI NDRYSHIMET NË
MARRËVESHJEN NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS ÇEKE PËR
NXITJEN DHE MBROJTJEN RECIPROKE TË INVESTIMEVE, NËNShKRUAR MË 27 QERSHOR
1994 NË PRAGË**

Republika e Shqipërisë dhe Republika Çeke (këtej e tutje të referuara si “Palë kontraktuese”) kanë rënë dakord për ndryshimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Çeke për nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve, të nënshkruar më 27 qershor 1994, në Pragë (këtej e tutje referuar si “Marrëveshja”), si vijon:

Neni 1

Paragrafi 3 i nenit 3 të marrëveshjes fshihet dhe zëvendësohet me paragrafët e rinj nga 3 deri tek 5, sa vijon:

“3. Dispozita për trajtimin kombëtar dhe atë të kombit më të favorizuar

Trajtimi i këtij neni nuk do të zbatohet për të akorduar avantazhet e një pale kontraktuese në përputhje me detyrimet e tij si një anëtar i një bashkimi doganor, ekonomik apo monetar, e një tregu të përbashkët ose e një zone të tregtisë së lirë.

4. Pala kontraktuese i njeh detyrimet e palës tjetër kontraktuese si një anëtare e një bashkimi doganor, ekonomik apo monetar, e një tregu të përbashkët ose e një zone të tregtisë së lirë, për përfshirjen e detyrimeve që rrjedhin nga një marrëveshje ndërkombëtare ose nga një marrëveshje reciprociteti e atij bashkimi doganor, ekonomik ose monetar, të tregut të përbashkët ose të zonës së tregtisë së lirë.

5. Dispozitat e kësaj marrëveshjeje nuk do të interpretohen në mënyrë që të detyrojnë një palë kontraktuese të shtrihet deri tek investitorët e palës tjetër kontraktuese, ose tek investimet, të ardhurat e investitorëve të tjerë, përfitime nga çdo trajtim, privilegj apo preferencë, të cilat mund të zbatohen nga

pala kontraktuese duke u mbështetur në cilindo marrëveshje ndërkombëtare ose angazhim që lidhen tërësisht ose kryesisht me taksat.”.

Neni 2

Në nenin 6 të marrëveshjes, në fillim të fjalisë së parë të paragrafit 1, janë shtuar fjalët e mëposhtme:

“Pa cenuar masat e miratuara nga Komuniteti European.”.

Neni 3

Neni i ri 11 është shtuar pas nenit 10 të marrëveshjes, me këtë përmbajtje sa vijon:

“Interesat thelbësorë të sigurimit

1. Asgjë e përcaktuar në këtë marrëveshje nuk do të interpretohet në mënyrë të tillë që të pengojë ndonjërin prej palëve kontraktuese për marrjen e masave të cilat konsiderohen si të nevojshme për mbrojtjen e interesave të saj thelbësorë të sigurisë:

- a) në lidhje me vepra kriminale ose penale;
- b) në lidhje me trafikun e armëve, të municioneve dhe mjeteve të luftës, si dhe marrëveshjet për mallrat, materialet, shërbimet dhe teknologjinë e ndërmarrë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi për qëllim furnizimin e njësisë ushtarake ose të sigurisë;
- c) të ndërmarra në kohë lufte ose gjendje të jashtëzakonshme në marrëdhëniet ndërkombëtare; ose

d) në lidhje me zbatimin e politikave kombëtare ose marrëveshjeve ndërkombëtare, duke respektuar mospërhapjen e armëve bërthamore apo mjeteve të tjera me shpërthim bërthamor; ose

e) në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Karta e Kombeve të Bashkuara për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.

2. Interesat bazë të sigurisë të një pale kontraktuese mund të përfshijnë edhe interesat që vijnë si rrjedhojë e një anëtarësimi të saj në një bashkim doganor, ekonomik e monetar, në një treg të përbashkët ose në një zonë të tregtisë së lirë.”.

Nenet pasuese të marrëveshjes do të rinumërohen.

Neni 4

Protokolli do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas njoftimit më të fundit me të cilin palët kontraktuese do të komunikojnë njëra-tjetrën, se procedurat e tyre të brendshme ligjore për hyrjen e saj në fuqi kanë përfunduar. Protokolli do të mbetet në fuqi për aq kohë sa marrëveshja.

Bërë në 8.10.2010 në dy kopje origjinale në gjuhët shqipe, çeke dhe angleze, të gjitha tekstet janë me të njëjtën vlerë autentike. Në rast mosmarrëveshjeje në interpretim, do të mbizotërojë teksti në gjuhën angleze.